

VENDIM
Nr.599, datë 10.9.2004

**PËR DISA NDRYSHIME NË STATUTIN E FONDIT TË ZHVILLIMIT SHQIPTAR,
MIRATUAR ME VENDIMIN NR.207, DATË 28.4.1999 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 124 e 128 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Zëvendëskryeministrit, Këshillit i Ministrave

VENDOSI:

Në nenin 9 të statutit të Fondit të Zhvillimit Shqiptar, miratuar me vendimin nr.207, datë 28.4.1999 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto ndryshime:

1. Pas emërimit “- Ministri i Pushtetit Vendor dhe i Decentralizimit;” shtohet “- Ministri i Integritimit European;”.

2. Paragrafi “- një përfaqësues i bashkive, i caktuar nga Shoqata e Kryetarëve të Bashkive, me mandat 3-vjeçar.” ndryshohet dhe bëhet “- dy përfaqësues të bashkive, të caktuar nga Shoqata e Kryetarëve të Bashkive, me mandat 3-vjeçar;”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano